



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 85

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË BERAT, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 11.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Berat.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 85
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike”

1. "Kryetari i bashkisë Berat ka postuar në faqen e tij në "Facebook", zhvillimin e një aktiviteti "Sot e kaluam ditën në shkollën jopublike "Irfan Ngjeqari". Postimi mban datën 3 Shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 3 Shkurt ose përpara kësaj date. Ndërkohë nga konsultimi i ndërfaqes së raportimeve të KQZ, rezulton se në datën 6 Shkurt 2023, bashkia Berat ka raportuar për një aktivitet me temë "Vizitë në shkollën jo publike "Irfan Ngjeqari", me stafin akademik, maturantët etj", të cilin planifikon ta zhvillojë më datën 20 Shkurt 2023".
2. "Kryetari i bashkisë Berat, z. Ervin Demo ka postuar në faqen e tij në "Facebook", zhvillimin e një aktiviteti "Vizitë e këndshme sot në shkollën jopublike "Drita e Dijes". Postimi mban datën 1 Shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 1 Shkurt 2023 ose përpara kësaj date. Ndërkohë nga konsultimi i ndërfaqes së raportimeve të KQZ, rezulton se në datën 6 Shkurt 2023, bashkia Berat ka raportuar për një aktivitet me temë "Vizite në shkollën jopublike "Drita e Dijes" me stafin edukues, maturante etj", të cilin planifikon ta zhvillojë më datën 17 Shkurt 2023".

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 17.2.2023, bashkia Berat ndër të tjera bën me dije se: "Në vijim të komunikimeve që kemi patur me instancat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me raportimet, në ndërfaqen e raportimeve të aktiviteteve të KQZ-së për bashkinë Berat, janë raportuar 2 (dy) aktivitete në datat 17 Shkurt 2023, dhe 20 Shkurt 2023. Këto aktivitete ishin planifikuar me tematikat e përcaktuara në 2 shkolla jo-publike, përkatësisht "Drita e Dijes" dhe "Irfan Ngjeqari". Theksojmë se këto dy vizita të planifikuara për datat 17 dhe 20 Shkurt 2023, janë zhvilluar realisht në datat 1 Shkurt dhe 3 Shkurt 2023, pasi axhenda e planifikuar nga Drejtoria e Aktiviteteve dhe Turizmit në Bashkinë Berat kishte ndryshuar për shkak të disa impenjimeve dhe takimeve/vizitave të paplanifikuara të donatorëve të huaj me të cilët bashkia Berat ka marrëveshje bashkëpunimi për projekte të ndryshme. Ndryshimet e kryera në axhendën e Drejtorisë së Aktiviteteve dhe Turizmit nuk janë raportuar në kohë me personin përgjegjës për raportimin e aktiviteteve të bashkisë Berat dhe për rrjedhojë nga ky i fundit është raportuar sipas datave të përcaktuara në axhendë pa u njoftuar për ndryshimet e ndodhura së fundmi përsa

Data: 3 Mars 2023

Nr: 85

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike"

mësipër ju shpjeguam. Lidhur me kërkesën tuaj për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktiviteteve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, ju informojmë se:

1. Takimi i zhvilluar në shkollën "Drita e Dijes" më datë 1.2.2023, ora 11:00, organizuar nga bashkia Berat, me tematikë "Inspektim i punimeve infrastrukturore arsimore" dhe me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Arsimit pranë bashkisë Berat është mediatizuar vetëm në facebook dhe instagramin personal të Kryetarit të Bashkisë.

2. Takimi i zhvilluar në shkollën "Irfan Ngjeqari" më datë 3.2.2023, ora 11:00, organizuar nga bashkia Berat, me tematikë "Aktivitet me maturantë dhe stafin akademik të shkollës" dhe me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Arsimit pranë bashkisë Berat është mediatizuar vetëm në facebook dhe instagramin personal të Kryetarit të Bashkisë".

Nga verifikimi i të gjitha provave dhe fakteve në mbështetje të sa më sipër, çmohet se referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, aktivitetet e kryera nga kryetari i bashkisë Berat nuk përbëjnë veprimtari publike. Për rrjedhojë raportimi me vonesë i këtyre aktiviteteve nuk cënon në thelb parashikimet ligjore mbi raportimin e veprimtarive publike në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Berat, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Berat.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Berat, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike pa vonesa dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Data: 3 Mars 2023

Nr: 85
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike"

4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 3 Mars 2023

Nr: 85
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Berat, për raportimin e veprimtarive publike”